VENDIM
Nr. 174, datë 24.12.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË "ALBANIAN GREEN ENERGY" SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HEC "SMOKTHINA" SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 5 pika 8, 6, 7 dhe 8 të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, nenit 18 pika 1 germa "d", të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Albanian Green Energy" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec "Smokthina", si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "Albanian Green Energy" sh.p.k., është konform "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike", nga burimet e rinovueshme si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat "a", "b", "c", "d"

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat "a", "b", "c", "d"

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur ne mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat "a", "b", "c"

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec "Smokthina", si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani